

**URDHËR**  
**Nr. 274, datë 19.7.2019**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR MIRATIMIN E SHËRBIMEVE,  
TRAJNIMEVE, WORKSHOPE-ve JASHTË VENDIT, PËR NËPUNËSIT E  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE INSTITUCIONET E  
VARËSISË**

Në bazë të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kreut II, neni 28 “Për delegim kompetence dhe zëvendësim të tyre të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013 të ministrit të Financave, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimi i shërbimeve, trajnimeve dhe Workshope-ve jashtë vendit, për punonjësit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë, të bëhet nga zëvendësministri përkatës, kompetencat e të cilëve janë të përcaktuara në urdhrin nr. 43, datë 11.2.2019, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Mbi caktimin e fushave të përgjegjësisë dhe detyrave kryesore të Zëvendësministrave të MFE-së”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në MFE dhe institucionet në varësi të saj.

3. Urdhri nr. 5, datë 4.1.2019, “Për delegimin e kompetencave për miratimin e shërbimeve jashtë vendit për punonjësit e MFE-së dhe institucionet e varësisë”, shfuqizohet .

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Anila Denaj**